

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 7014
E premte, 6 tetor 2023
Çmimi 0.50

KMDLNj: 'Fondi i klasës', mbulesë e dështimit institucional!



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FILLON FUSHATA INFORMUESE PËR LIBERALIZIMIN E VIZAVE

FAQE 3



Në Prishtinë të enjten ka filluar fushata informuese lidhur me liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës, të cilët nga 1 janari 2024 nuk kanë nevojë më të presin para ambasadave për t'u pajisur me vizë për vizitë në vendet e BE-

së, gjegjësisht vendet që janë në zonën Shengen. Kryeministri Albin Kurti, i cili ka marrë pjesë në hapjen e kësaj fushate, ka thënë se liberalizimi i vizave ka qenë një projekt i tejzgatur dhe i vonuar për qytetarët e Kosovës,

ndërkaq ka kërkuar kujdes nga qytetarë sepse liberalizimi ka edhe disa rregulla që duhen respektuar. Pjesë e fushatës informuese ishin edhe shefi i Zyrës së BE-së në Kosovë, ambasadori gjerman, italian dhe ai francez

OSMANI: NUK KA ARSYE PËR TAKIM ME PRESIDENTIN SERB PA NDËSHKIMIN E SERBISË PËR SULMIN E 24 SHTATORIT

FAQE 5



KDI-ja U BËNË THIRRJE PUSHTETIT DHE OPOZITËS TË BASHKËPUNOJNË PËR VOTIMIN E MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE

FAQE 4



RENOVA
PUTZ
Mqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mbx: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

AKTUALE



BIDENI MIRATON NDËRTIMIN E MURIT ME MEKSIKËN PAS RRIJTJES SË NUMRIT TË MIGRANTËVE

F. 2

SZUNYOG: JEMI DËSHMITARË TË NJË TRENDI SHOQËTËSUES, ANËTARËT E QEVERISË I KRITIKOJNË VENDIMET E GJYKATAVE

F. 6

KUZHINA QENDRORE REGJISTRON TË HYRA PËR 152 MIJË EURO MË SHUMË SE VITIN E KALUAR

F. 6

EKONOMI



"PAKOJA E ENERGISË DHE PROJEKTET E TJERA TË FINANCIARA NGA BE-JA PO TREGOJNË REZULTATE POZITIVE"

F. 8

BQK-ja: INVESTIMET DIREKTE NË KOSOVË ARRIJNË MBI 440 MILIONË EURO

F. 8

SPORT



MUSLIJA, LOJTARËVE TË RINJ: 'DARDAN' ME VEPRA, JO ME FJALË

F. 10

Konfirmohet emërimi i James O'Brien ndihmëssekretar amerikan i Shtetit

WASHINGTON, 5 TETOR - Senati amerikan e ka konfirmuar emërimin e James O'Brien Ndhmëssekretar i Shtetit për Evropë dhe Euroazi. Emërimi i tij është mbështetur nga 67 senatorë, derisa 31 anëtarë kanë qenë kundër. O'Brien është emëruar në

këtë pozitë nga presidenti amerikan Joe Biden më 19 maj. Ai është pjesë e Departamentit amerikan të Shtetit që prej vitit 1989. Përgjatë karrierës së tij të gjatë, ai është marrë edhe me çështje të Ballkanit, si i dërguar i posaçëm i presidentit dhe ka marrë pjesë në negociata të

paqes në Kosovë dhe Bosnjë-Hercegovinë. Në administratën e ish-presidentit amerikan Barack Obama ai ka qenë i dërguar i posaçëm për çështje të pengjeve dhe më 2021, Bideni e ka emëruar koordinator për sanksione në Departamentin amerikan të Shtetit.



Bideni miraton ndërtimin e murit me Meksikën pas rritjes së numrit të migrantëve

WASHINGTON, 5 TETOR - Administrata e presidentit amerikan, Joe Biden, do ta ndërtojë një pesë të murit në jug të Teksasit, teksa rriten përpjekjet për ta bllokuar rritjen e numrit të migrantëve. Muri rreth 32 kilometra do të ndërtohet në qarkun Starr, përgjatë kufirit me Meksikën, ku zyrtarët janë duke raportuar për numër të madh të kalimeve kufitare. Ndërtimi i murit ka qenë plan i ish-presidentit amerikan Donald Trump dhe është kritikuar ashpër nga demokratët. Më 2020 Bideni është zotuar se nuk do ta ndërtojë asnjë

pjesë të murit nëse i fiton zgjedhjet. Mirëpo, rritja e numrit të kalimeve të paligjshme kufitare e ka bërë këtë çështje sfiduese për presidentin. Të dhënat qeveritare tregojnë se vetëm këtë vit kufirin me ShBA-në e kanë kaluar 245 000 persona, dhe vetëm shifrat e shtatorit pritet të shënojnë rekord. Sipas një propozimi të Departamentit amerikan për Mbrojtje Kufitare dhe Dogana, ndalesa do të krijohet me shtylla të mëdha betoni si dhe me porta ndaluese, kamera dhe pajisje të tjera vëzhgimi.



Jon Fosse, laureat i çmimit Nobel për letërsi



OSLO, 5 TETOR - Shkrimtari dhe dramaturgu norvegjez Jan Fosse e ka fituar çmimin Nobel për letërsi këtë vit. Akademia Suedeze në Stokholm i ka vlerësuar dramën dhe prozën e tij novatore dhe ka thënë se autori u ka dhënë zë të pathënave. Veprat e tij janë përkthyer në shumë gjuhë të botës. Jon Fosse ka thënë se është "i tronditur dhe disi i frikësuar" që e ka fituar këtë çmim prestigjioz. Ky çmim e ka vlerën e rreth 1

milion dollarëve amerikanë. Akademia Suedeze ka thënë se Fosse, i lindur më 1959 në Haugesund, në brigjet perëndimore të Norvegjisë, ka krijuar në shumë zhanre letrare, përfshirë novela, koleksione poezish, ese, libra për fëmijë dhe përkthime. Ai është bërë i njohur si dramaturg me veprën "Nokon kjem til å komme" (Dikush do të vijë). Fosse, 64-vjeçar, i cili shkruan në versionin më të pazakonshëm të dy versioneve

zyrtare të gjuhës norvegjeze, ka thënë se e konsideron çmimin si njohje të gjuhës që përdor dhe lëvizje për promovim të saj, duke thënë se Nobelin ia dedikon vetë asaj. E njohur si "norvegjishtja e re" dhe e përdorur nga rreth 10 për qind e popullsisë së Norvegjisë, versioni që përdor Fosse është krijuar në shekullin 19 në zonat rurale, duke e bërë atë alternativë ndaj gjuhës daneze që është përdorur përgjatë një bashkimi 400-vjeçar me Danimarkën.

Viti 2023 mund të jetë më i nxehti ndonjëherë

LONDËR, 5 TETOR - Viti 2023 do të mund të jetë më i nxehti në histori, sipas Shërbimit të Bashkimit Evropian për Ndryshime Klimatike, Copernicus. Shtatori më i nxehtë në gjithë botën, ndonjëherë, është regjistruar pas një vere me rekord temperaturash të larta, ka thënë Copernicus. Temperaturat në shtator, këtë vit, kanë qenë gjysmë grade më të larta sesa në shtatorët më të nxehtë në të

kaluarën dhe pothuajse një gradë më të larta sesa shtatorët në periudhat 1991-2020. "Temperaturat e pashembullta në këtë shtator - që e pason një verë me temperatura rekorde, i kanë thyer të gjitha rekordet në shkallë të jashtëzakonshme", ka thënë Samantha Burgess, zëvendës drejtoreshë e agjencisë së BE-së. Temperaturat në vitin 2023 janë 1.4 gradë celsius përtej

temperaturave të epokës industriale, ka thënë Burges. Kjo shifër është vetëm 0.1 gradë më e vogël sesa synimi i bërë në Marrëveshjen e Parisit për Klimën, që parashihet kufizimin e temperaturës globale në 1.5 gradë celsius deri në fund të shekullit. Akulli në Antarktik ka arritur në nivele historike të ulëta në shtator, duke mbuluar 9 për qind më pak territor sesa në periudhën 1991-2020.



Gjetjet janë bazuar në analiza që përfshijnë miliarda të dhëna nga satelitët, anijet, aeroplanët dhe stacionet meteorologjike në gjithë botën.

Fillon fushata informuese për liberalizimin e vizave

Në Prishtinë të enjten ka filluar fushata informuese lidhur me liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës, të cilët nga 1 janari 2024 nuk kanë nevojë më të presin para ambasadave për t'u pajisur me vizë për vizitë në vendet e BE-së, gjegjësisht vendet që janë në zonën Shengen. Kryeministri Albin Kurti, i cili ka marrë pjesë në hapjen e kësaj fushate, ka thënë se liberalizimi i vizave ka qenë një projekt i tejzgjatur dhe i vonuar për qytetarët e Kosovës, ndërkaq ka kërkuar kujdes nga qytetarë sepse liberalizmi ka edhe disa rregulla që duhen respektuar. Pjesë e fushatës informuese ishin edhe shefi i Zyrës së BE-së në Kosovë, ambasadori gjerman, italian dhe ai francez

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 5 TETOR - Ka nisur fushata informuese lidhur me liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës të cilët nga 1 janari 2024 nuk kanë nevojë më të presin para ambasadave për t'u pajisur me vizë për vizitë në vendet e BE-së, gjegjësisht vendet që janë në zonën Shengen.

Të enjten në sheshin "Skënderbeu" në Prishtinë janë shpërndarë broshura për qytetarët në të cilat pasqyrohen rregullat e këtij procesi.

Në njoftimin e lëshuar për medie nga Integrimi Evropian i Kosovës është theksuar se liberalizimi i vizave është një hap shumë i rëndësishëm për qytetarët e Kosovës. "Kjo do të thotë që ju tani keni mundësinë e udhëtimit pa vizë për qëndrime afatshkurtra, duke përfshirë vizitat turistike dhe udhëtimet për të vizituar familjarët, disa herë brenda vitit. Kujdes, megjithatë, që të mos tejkaloni 90 ditët brenda një periudhe prej 180 ditësh. Për të udhëtuar pa vizë, kërkojnë dokumente të rëndësishme si pasaportë biometrike, dëshmi mbi qëllimin e udhëtimit, rezervimin e vendit të qëndrimit, detajet e udhëtimit, dokumentet për



veturën nëse udhëtoni me të, dhe dëshmi për mjete të mjaftueshme financiare. Kujdes, megjithatë, liberalizimi i vizave nuk ju mundëson të punoni, të ndiqni shkollimin, ose të kryeni studime në zonën Shengen", është bërë me dije në këtë njoftim, duke

theksuar se shkeljet e rregullave apo abuzimi i kësaj të drejte mund të sjellin pasoja të rënda, duke përfshirë gjoba financiare, shënim në pasaportën tuaj dhe ndalim të hyrjes në zonën Shengen deri në pesë vjet.

Kryeministri Albin Kurti ka

marrë pjesë në hapjen e fushatës informuese për liberalizimin e vizave. Ai ka thënë se liberalizimi i vizave ka qenë një projekt i tejzgjatur dhe i vonuar për qytetarët e Kosovës. Ai ka pohuar se qytetarët duhet të kenë kujdes sepse liberalizmi ka edhe disa rregulla.

"Përgjatë tetorit dhe nëntorit pritet që fushata të zhvillohet në shumë komuna e anembanë. Siç e dini të gjithë, sepse edhe e kemi përjetuar, ky projekt ka qenë i tejzgjatur dhe i vonuar për qytetarët e Kosovës. Nga 1 janari merr fund regjimi i vizave për Kosovën. Liberalizimi edhe pse do të thotë lëvizje e lirë duhet të kemi kujdes sepse ka edhe disa rregulla. Liberalizimi është për vizita afatshkurta dhe jo për shkollim e për punë. Duhet të keni kujdes sepse shkeljet e rregullave kur të mblidhen mund të dërgojnë në gjoba dhe në ndalesa për hyrje në Shengen", ka deklaruar kryeministri Kurti.

Edhe shefi i Zyrës së BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog, u ka bërë thirrje qytetarëve të Kosovës që pas 1 janarit 2024, kur edhe do të ndodhë

liberalizimi i vizave, t'i respektojnë rregullat. Ai bashkë me ambasadorin gjerman në Kosovë, Joern Rohde, atë të Francës, Oliver Guerot dhe të Italisë, Antonello De Riu, kanë marrë pjesë në fillimin e fushatës informuese për liberalizimin e vizave.

Szunyog më tej ka shtuar se qytetarët e Kosovës mund ta vizitojnë Evropën e familjarët e tyre, por që nuk kanë të drejtë të punojnë e qëndrojnë gjatë në vendet evropiane. "Liberalizimi i vizave do të bëhet më 1 janar të vitit të ardhshëm. Kosovarët do të mund të udhëtojnë në Evropë për t'i parë bukuritë e saj, qytetet evropiane dhe familjarët e tyre. Është e rëndësishme që kampanja ka filluar dhe që t'u shpjegohet qytetarëve çfarë është liberalizimi i vizave dhe çfarë nuk është. Qytetarët duhet ta kuptojnë që ka rregulla e ato duhet të ndiqen. Të gjithë duhet ta kuptojnë se liberalizimi i vizave do të thotë liberalizim i vizave për turistë. Nuk është për qëndrime të gjata. Nuk është për punë dhe as për studentët", ka theksuar Szunyog.





KDI-ja u bënë thirrje pushtetit dhe opozitës të bashkëpunojnë për votimin e marrëveshjeve ndërkombëtare

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka shprehur shqetësim lidhur me mosvotimin e marrëveshjeve ndërkombëtare. Të gjitha këto marrëveshje po presin ratifikimin me votat e 2/3 të deputetëve. KDI-ja u ka bërë thirrje pushtetit dhe opozitës të bashkëpunojnë për votimin e marrëveshjeve ndërkombëtare. Opozita në seancën e së mërkurës i ka thënë Kurtit se ishte shembulli më i keq i opozitarit që ka pasur Kosova ndonjëherë. E kryeministri Albin Kurti e ka akuzuar opozitën për bllokim të këtyre marrëveshjeve

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHINË, 5 TETOR - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka shprehur shqetësim lidhur me mosvotimin e marrëveshjeve ndërkombëtare nga ana e Kuvendit të Kosovës në seancën e së mërkurës. Pesë marrëveshje ndërkombëtare që ishin sjell për votim në këtë seancë kanë dështuar të miratohen në Kuvend që nga prilli i këtij viti, edhe pse kanë qenë pjesë e rendit të ditës në 28 seanca. Behet fjalë për marrëveshje që ndikojnë drejtpërdrejt në

mirëqenien e qytetarëve, për projekte si kredia për përmirësimin e rrjetit të transmetimit, kredia për rindërtim dhe zhvillim për projektin "Ngrohtorja solare e Prishtinës", marrëveshja për bashkëfinancimin e bursave të arsimit të lartë në nivelin master dhe kredia për programin e financave publike dhe rritjes ekonomike.

"Mosmiratimi i tyre përveç që dëmton interesin qytetar, rrezikon ta paraqesë Kosovën si partnere joserioze pasi ka marrë zotime dhe po dështon t'i zbatojë ato në praktikë, siç është rasti me njërin nga këto marrëveshje, ajo me

Mbretërinë e Danimarkës për shfrytëzimin e institucionit korrektues në Gjilan me qëllim të ekzekutimit të dënimeve daneze. Duke qenë se miratimi i marrëveshjeve ndërkombëtare kërkon 2/3 e votave në Kuvend, nevojitet bashkëpunim i gjerë politik mes pushtetit dhe opozitës. Natyrisht që përgjegjësinë kryesore për sigurimin e votave e ka partia në pushtet, e cila duhet t'u prijë përpjekjeve për konsensus. Rrjedhimisht, u kërkojmë subjekteve politike parlamentare që duke vënë në qendër interesin qytetar dhe shtetëror të Kosovës, ta gjejnë gjuhën e përbashkët për t'u hapur rrugë jetësimit të këtyre marrëveshjeve, duke i miratuar ato në Kuvend sa më parë", është thënë në komunikatën e KDI-së.

Kurti kritikon opozitën për mosvotimin e marrëveshjeve ndërkombëtare

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka kritikuar deputetët e opozitës në seancën e Kuvendit të enjten për shkak të mosvotimit të

marrëveshjeve ndërkombëtare. Ai në fjalën e tij ka theksuar se ka disa muaj që në këtë legjislaturë kuvendi, qeveria ka sjellë për ratifikim një sërë marrëveshjesh ndërkombëtare, mirëpo për shkak të mosvotimit nga opozita, ato nuk po kalojnë. "Janë shtatë marrëveshje që janë në pritje të miratimit në Kuvend, dy të tjera janë në shqyrtim në komisione e shumë të tjera janë në proces që pritet të vijnë nga Qeveria në Kuvend", është shprehur ai.

Kurti ka treguar se për cilat marrëveshje bëhet fjalë. "Marrëveshja financiare me Fondin Zhvillimor të OPEC-ut në vlerë prej 40 milionë dollarësh pret në Kuvend për ratifikim që prej datës 25 nëntor të vitit 2022. Marrëveshja për Projektin Solar4Kosovo me BERZhin në vlerë prej 23.2 milionë eurosh, e që pjesë e saj janë edhe 54.1 milionë euro grante, për projektin e zgjerimit të kapacitetit të Termokosit, pret në Kuvend për ratifikim që prej datës 23 mars 2023. Marrëveshja për Projektin e KOSTT-it me KfW-në Gjermane në vlerë 25.5 milionë euro, për renovimin e nënstacioneve të KOSTT-it nëpër

zonat dhe komunitat ku ka problem me tension të energjisë elektrike, pret në Kuvend për ratifikim prej datës 23 mars 2023. Marrëveshja për burgjet me qeverinë daneze, që siguron të ardhura buxhetore prej 150 milionë eurosh dhe një grant për investime në energji të ripërtërishme prej 27.5 milionë eurosh, pra gjithsej 177.5 milionë euro, pret në Kuvend për ratifikim që prej datës 9 qershor 2023. Marrëveshja për Linjën Hekurudhore 10, Hani i Elez-it-Leshak, me Bankën Evropiane Investive në vlerë 38 milionë euro, pret në Kuvend për ratifikim që prej datës 14 korrik 2023. Marrëveshja për projektin e promovimit të agroturizmit me GIZ-in, në vlerë 10 milionë euro, pret në Kuvend që prej datës 11 gusht 2023", ka pohuar kryeministri.

Ai ka bërë me dije se ka edhe marrëveshje që s'kanë të bëjnë me projekte infrastrukturore, por me bursa për studentë sikurse marrëveshja me Ambasadën e Francës, e vlera e këtyre marrëveshjeve gjithsej që janë pritje tejkalon shifrën 360 milionë euro. Kurti ka thënë se tani marrëveshjet

Osmani: Nuk ka arsye për takim me presidentin serb pa ndëshkimin e Serbisë për sulmin e 24 shtatorit

PRISHTINË, 5 TETOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë të enjten se nuk është e gatshme për takim me presidentin serb Aleksandër Vuçiq pa u sanksionuar fillimisht Serbia për sulmin e 24 shtatorit ndaj Policisë së Kosovës. "Nuk ka arsye për t'u takuar para se të vendosen sanksione kundër (Aleksandër) Vuçiqit fillimisht e më pas mund të diskutojmë për të tjerat", ka thënë presidentja Osmani.

Ajo i bëri këto komente para fillimit të samitit të Komunitetit Politik Evropian (EPC) në Granada të Spanjës. "Jam këtu për ta kërkuar mbështetjen e partnerëve dhe miqve evropianë

për ta sanksionuar Serbinë në mënyrë që ajo të mos nxitet për të kryer akte të tilla agresioni kundër Kosovës dhe vendeve të tjera fqinje sërish", ka deklaruar Osmani.

Ajo shfaqti shpresën se Spanja do t'u bashkohet vendeve të tjera evropiane në miratimin e masave kundër Serbisë. Spanja është një nga pesë vendet e Bashkimit Evropian që nuk e ka njohur pavarësinë e Kosovës. Tensionet ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës arritën një shkallë të pashembullt që nga pavarësia e Kosovës që nga 24 shtatori, kur një grup serbësh të armatosur sulmoi Policinë e Kosovës në fshatin Banjskë në veri duke

vrarë një oficer policie. Tre sulmues u vranë gjatë përleshjeve, që nxitën shqetësime për qëndrueshmërinë në rajon.

Kosova akuzon Serbinë për organizimin e këtij sulmi që është cilësuar si terrorist nga institucionet vendase si dhe Bashkimi Evropian, por Beogradi i ka mohuar lidhjet me ngjarjet e 24 shtatorit të cilat i mori përsipër Milan Radoiqi, nënkryetar i deritashëm i Listës Serbe, partisë më të madhe të serbëve të Kosovës që është themeluar dhe mbështetur nga Beogradi.

Presidenti i Këshillit Evropian, Charles Michel, ka thënë se

Komuniteti Politik Evropian duhet të shfrytëzohet si platformë për t'i zgjidhur situatat si ato në Kaukaz apo ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. "Konfliktet nuk janë problem vetëm për ata që janë të përfshirë, por edhe për rajonin dhe kontinentin".

NATO-ja tha javën e kaluar se do ta shtojë praninë e trupave paqeruajtëse në Kosovë.

Ky samit do të mbledhë krerë shtetesh nga 47 vende të kontinentit evropian si dhe liderët e institucioneve evropiane me qëllim të nxitjes së dialogut politik dhe forcimit të bashkëpunimit për t'i adresuar çështjet më urgjente të sigurisë dhe stabilitetit në Evropë në

mënyrë që Evropa të jetë më e qëndrueshme, e begatë dhe gjeostrategjike.

Krahas pjesëmarrjes në sesionet kryesore të Komunitetit Politik Evropian, presidentja Osmani do të zhvillojë edhe diskutime me liderë evropianë për t'i informuar lidhur me agresionin e Serbisë kundër Kosovës dhe për të diskutuar për thellimin e bashkëpunimit për tejkalimin e sfidave të përbashkëta. Para liderëve evropianë, presidentja Osmani pritet ta përçojë mesazhin e përkushtimit të palëkundur të popullit dhe institucioneve të Republikës së Kosovës për paqe, stabilitet dhe siguri në vend dhe rajon.



që po presin ratifikimin nuk janë as të dëmshme as nuk shkaktojnë obligime që rrezikojnë qëndrueshmërinë financiare të Kosovës. "Përkundrazi, kemi të bëjmë me mbi 360 milionë euro, që ose janë kredi të buta me kushte koncesionale, ose janë grante, para falas e që nuk duhet të kthehen fare dhe do të investohen në projekte zhvillimore, që janë aq të nevojshme për vendin tonë. Madje që marrëveshjet janë në dobi të qytetarëve, për këtë pajtohet edhe opozita. Dhe, megjithatë, nuk po i voton", ka thënë ai.

Kurti ka thënë se detyra e opozitës është të tregojë se si mund të bëhet më mirë e jo t'i bllokojë punët në kurriz të qytetarëve. "Nuk mund të thuash po e bëj opozitën e po

brengosem për qytetarët kur bllokohet Ligji për Çmimet Tavan. Nuk mund të thuash po bëj opozitën e po brengosem për punëtorët kur bllokohet Ligjin për Pagën Minimale. Nuk mund të thuash po bëj opozitën e po brengosem për ekonominë e vendit kur bllokohet marrëveshjet ndërkombëtare për projekte zhvillimore", është shprehur kryeministri.

Kurti ka theksuar se nga viti 2011 deri në vitin 2020, kur Lëvizja Vetëvendosje ka qenë opozitë parlamentare në Kuvend, janë votuar 377 marrëveshje ndërkombëtare. Sipas tij, nga 377 marrëveshje ndërkombëtare për një dekadë, vetëm tri marrëveshje nuk i ka mbështetur Lëvizja

Vetëvendosje. "...dhe ato dihet se çfarë kanë qenë", ka deklaruar Kurti.

Opozita, Kurtit: Ti je shembulli më i keq i opozitarit që ka pasur Kosova ndonjëherë

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, në seancën e së mërkurës ia ka kujtuar Kurtit se sa ishte në opozitë partia që drejton nuk i kishte votuar marrëveshjet ndërkombëtare. "Ti je shembulli më i keq i opozitarit që ka pasur Kosova ndonjëherë. Dhe sa për që ti i ke mbështetur marrëveshjet, ti as Marrëveshjen për Stabilizim Asociim, më të

rëndësishmen për Kosovën, nuk e ke mbështetur", ka thënë Krasniqi. Ai ka theksuar se Kosova sot është e sanksionuar dhe e përjashtuar prej programeve të ndryshme ndihmuese të BE-së për shkak të qasjes dhe veprimeve të kryeministrit Kurti. "I kemi gati 500 milionë euro që i kemi votuar ne deri tash këtu si opozitë, pra bashkë me shumicën në çdo marrëveshje ndërkombëtare. Çka po ndodh me to? As nuk keni filluar t'i implementoni gjysmën prej tyre. Nuk je ti duke u brengosur as për punëtorin dhe as për asnjë kategori në Kosovë", ka deklaruar Krasniqi. Deputeti i LDK-së, Armend Zemaj, ka thënë se Vetëvendosja nuk mund t'i tregojë LDK-së se çfarë do të thotë votimi i marrëveshjeve

ndërkombëtare. "T'i tregosh LDK-së se çka do të thotë votimi i marrëveshjeve ndërkombëtare është si ai fëmija i papjekur që i thotë babës së vet, hajde babë t'i tregoj mexhat. Këtu i ke dëshmitë se me kë i ke kaluar marrëveshjet", ka thënë ai.

Zemaj i tha Kurtit të vazhdojë me sfilata, populizëm dhe demagogji por, sipas tij, kjo nuk do t'i bëjë nder. "Mos u mundo fajin tuaj t'ia hedhësh opozitës", është shprehur Zemaj.

Në anën tjetër deputetja e AAK-së, Time Kadrijaj, ka thënë se Kurti është i sanksionuar. "Edhe nëse votohen këto marrëveshje ndërkombëtare nuk lejohen të implementohen", ka deklaruar deputetja Kadrijaj.

Komuna e Vushtrrisë vazhdon t'i përkrahë fermerët përmes subvencioneve

VUSHTRRI, 5 TETOR - Komuna e Vushtrrisë po vazhdon mbështetjen e fermerëve përmes subvencioneve. Kryetari i kësaj komune,

Ferit Idrizi, ka njoftuar se është hapur thirrja për subvencionimin e fermerëve me 4 euro për shoqëri bletësh, 4 euro për

krerë dele e dhi dhe 100 euro për krerë buallce, që si subvencionim përbën risi në komunën e Vushtrrisë për këtë specie

në zhdukje. "Të gjitha premtimet për fermerët tanë janë duke u realizuar!", ka shkruar Idrizi në "Facebook".



Szunnyog: Jemi dëshmitarë të një trendi shqetësues, anëtarët e qeverisë kritikojnë vendimet e gjykatave



Prishtinë, 5 tetor - Ambasadori i BE-së në Kosovë, Tomas Szunnyog, është takuar të enjten me kryesuesin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Albert Zogaj, me të cilin ka diskutuar mbi zhvillimet e fundit në sistemin e drejtësisë dhe

për ta rikonfirmuar mbështetjen e vazhdueshme të BE-së për sundimin e ligjit në Kosovë. Duke theksuar se pavarësia e gjyqësorit është gur themeli i sundimit të ligjit dhe një kërkesë esenciale për çdo shoqëri

demokratike, ambasadori i BE-së në Kosovë tha: "Fatkeqësisht, jemi dëshmitarë të një trendi shqetësues, ku anëtarët e qeverisë kritikojnë vendimet e gjykatave, zhvillimin e hetimeve në vazhdim apo edhe prokurorët dhe

gjyqtarët individualë. Gjyqësori duhet të jetë i lirë nga presioni politik në mënyrë që të respektohet ndarja e pushteteve dhe sistemi i kontrolleve dhe balancave". Duke përsëritur përpjekjet e

vazhdueshme për përmirësimin e cilësisë së statistikave në lidhje me lëndët e zgjidhura gjyqësore, ambasadori i BE-së në Kosovë tha se statistikave të besueshme janë kryesore për ta vlerësuar efikasitetin e sistemit të drejtësisë. "Ato janë, gjithashtu, një mjet për t'ia komunikuar publikut punën e bërë, në mënyrë që të rritet besimi i qytetarëve në gjyqësor", ka pohuar ai.

Teksa rikujtoi deklaratën e nënshkruar të përkushtimit të përbashkët për reformat në drejtësi, e cila u mirëprit nga BE-ja, Szunnyog ka theksuar rëndësinë e forcimit të mekanizmave ekzistues për llogaridhënien, integritetin, efikasitetin dhe transparencën e sistemit gjyqësor.

Gjatë takimit të dy bashkëbiseduesit shkëmbyen mendime edhe për procesin e reformave në vazhdim dhe planet e investimeve në sistemin e drejtësisë me qëllim të përmirësimit të qasjes në drejtësi. Në këtë drejtim ambasadori i BE-së në Kosovë rikonfirmoi mbështetjen e fuqishme të BE-së për sundimin e ligjit në Kosovë, duke përfshirë edhe përmes disa projekteve të financuara nga BE-ja.

Kuzhina Qendrore regjistron të hyra për 152 mijë euro më shumë se vitin e kaluar

Prishtinë, 5 tetor - Kryeshefi ekzekutiv i Kuzhinës Qendrore, Asdren Osaj, ka bërë me dije se kjo kuzhinë ka regjistruar të hyra për 152 mijë euro më shumë se vitin e kaluar, duke arritur shifrën totale 792 mijë euro inkasim. "Buxheti është shtuar falë riorganizimit dhe

funksionalizimit të kuzhinës dhe hapjes së sektorit të shitjeve në sektorin privat. Kjo ndërmarrje ka përmirësuar menynë e ushqimit për fëmijët parashkollorë. Faleminderit për mbështetjen, kryetar Përparim Rama!", ka shkruar Osaj në "Facebook".



Në rrugën "Eqrem Çabej" në Prishtinë do të shtohet edhe një kors

PRISHTINË, 5 TETOR - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka bërë me

dije se janë duke e shtuar edhe një kors në rrugën "Eqrem Çabej" në

kryeqytet. Ai ka thënë se zgjerimi i rrugës do ta lehtësojë qarkullimin e

mjeteve të transportit dhe do ta shkarkojë komunikacionin.



KMDLNj: 'Fondi i klasës', mbulesë e dështimit institucional!

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka bërë me dije se ka pranuar disa ankesa nga prindërit të cilët po obligohen të japin kontribut financiar për "Fondin e klasës", i cili shërben për t'i mbuluar mungesat që kanë shkollat. Sipas KMDLNj-së, ky fond do të duhej të bëhej nga drejtoritë komunale të arsimit

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 5 TETOR - Pak para fillimit të vitit shkollor dështoi marrëveshja midis MASHTI-t dhe botuesve të librave shkollorë dhe, si rezultat i kësaj, në vend se librat të shpërndahen si më parë, u gjet një tjetër rrugë që përmes aplikimit për rimbursim të kompensohen prindërit që i blejnë tekstet shkollorë për fëmijët e tyre. E tëra kjo shkaktoi një rrëmujë në libraritë apo pikat shitëse, ku të njëjtët botues që nuk arritën marrëveshje me MASHTI-n, tash i shesin librat shkollorë.

U krijuan radhë të gjata, viti shkollor filloi me vonesa, nxënësit që nuk ishin pajisur me tekste të reja, ose shkuan me tekste të vjetra ose fare pa to.

Për shpenzimin e blerjes së librave, të ndarë në dy kategori, për fëmijët nga klasa e parë deri te klasa e pestë dhe për të tjerët nga klasa e pestë deri në klasën e nëntë, u kujdes Ministria e Arsimit përmes formës online të aplikimit për rimbursim të shpenzimeve. Por, pasi filloi muaji i parë në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme të të gjitha cikleve, janë

mbajtur mbledhjet e prindërve.

Tashmë është bërë një rregull i pashkruar e i pakodifikuar që për shumicën e nevojave që kanë shkollat, përkatësisht klasat, mjetet financiare dhe mbulimi i asaj mungese të bëhet nga prindërit. "Në të gjitha mbledhjet njëra nga pikat e rendit të ditës (ajo më kryesorja) është 'fondi i klasës', i cili shërben për të mbuluar mungesat që kanë shkollat, apo thënë më mirë dështimet e drejtorive komunale të arsimit por edhe së Ministrisë së Arsimit. Ky 'fond' organizohet në mënyrë që secili prind duhet të kontribuojë me së paku nga 10 euro (ka raste kur edhe më shumë) për t'i ndihmuar mësuesve që me këtë të mbulojnë kopjet e testeve, letrat e bardha ose me ngjyrë në raste të tjera, për të blerë materiale didaktike, shkurtesa, dosje, karrige, tabelë për klasë, banka, perde, e në disa raste lap top për mësuesit/et, projektorë, etj. Pra, 'fondi i klasës' është bërë rrugëgjidhja më e lehtë për të ofruar kushtet, në disa raste minimale për fëmijët dhe mësuesit/et që të zhvillojnë mësimin normal", është thënë në reagimin e KMDLNj-së.



KMDLNj ka bërë me dije se ka pranuar disa ankesa nga prindërit të cilët po obligohen (në disa raste kanë pohuar se janë liruar, por për arsye që të mos ndihen keq fëmijët e tyre disa prindër kanë kontribuar) për të dhënë kontribut financiar të paarsyeshëm kur për gjërat që shfrytëzohet "fondi i klasës" do të duhej të kujdesej drejtoria/të komunale të arsimit. "Merreni me mend që është në vitin 2023 në shkollat e Kosovës mungojnë shkurtesat e letrat e bardha që çmimi i tyre është gati i papërfillshëm! Merreni me mend që në Kosovë në shkollat publike obligohen prindërit që të

blejnë banka e karrige! KMDLNj është kundër kësaj praktike jo të mirë të obligimit të prindërve që të japin kontribut financiar për material didaktik e shkollor në vend se këto mungesa t'i plotësojë drejtoritë komunale të arsimit. Me këtë KMDLNj merr shkas dhe kërkon nga Ministria e Arsimit, përkatësisht Inspekcioni i Arsimit që të bëjnë inspektime të hollësishme për kushtet e të gjitha shkollave ku zhvillohet mësimi të të gjitha niveleve dhe të publikohen gjetjet nga këto inspektime në mënyrë që institucionet e tjera përgjegjëse të mbahen përgjegjëse nga opinioni i gjerë për veprim ose

mosveprim", është thënë në këtë reagim.

Në të njëjtën kohë KMDLNj kërkon nga Qeveria e Kosovës të ndajë edhe nga 10 euro plus që t'i mbulojë shpenzimet e prindërve për shpenzimet që po mbulohen nga "fondi". "KMDLNj inkurajon të gjithë prindërit dhe ua përkujton se shkollimi publik është pa pagesë dhe për të gjithë materialet dhe kushte për zhvillim të mësimin janë të obliguara me ligj institucionet që të përmbushin, andaj prindërit nuk janë të detyruar të japin kontribut financiar", është theksuar në reagimin e KMDLNj-së.

Hoxha: Serbia, me sulmin në Banjskë, tentoi të krijojë një realitet të ri në Kosovë



PRISHTINË, 5 TETOR - Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Gazmend Hoxha, në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë", ka thënë se Kosova ka fakte të cilat dëshmojnë se shteti i Serbisë dhe Ushtria e Serbisë i kanë dhënë mbështetje të plotë ish-nënkryetarit të Listës Serbe, Millan Radoičiq, i cili ka organizuar dhe ka marrë pjesë në sulmin ndaj Policisë së Kosovës më 24 shtator në Banjskë, ku u vra rreshteri Afrim Bunjaku. Siç tha ai, qëllimi i tyre ka qenë të krijohej një realitet i ri në Kosovë. Hoxha ka bërë me dije se po hetohet edhe përfshirja e mundshme e disa personave që mund të jenë nga Rusia.

Gjatë intervistës Hoxha foli edhe për bashkëpunimin me KFOR-in gjatë sulmit në veri si dhe sfidat për monitorimin e vijës kufitare në mes të Kosovës dhe Serbisë. Hoxha mohoi çfarëdo marrëveshje për krijimin e

korridorit për ikjen e grupit të armatosur nga Kosova.

Se a ka ende rreziqe për sigurinë?, Hoxha është përgjigjur: "A ka kapacitet dhe a ka potencial për kërcënim? Ka. Kjo qëndron. E ajo çfarë ne po bëjmë, [është se] po punojmë shumë që tashmë ta avancojmë komunikimin dhe bashkëpunimin me KFOR-in, sidomos në edhe rreth vijës kufitare me Serbinë. Atje kemi shtuar praninë tonë policore, kemi rritur kapacitetet, jemi duke punuar që disa prej atyre rrugëve ilegale t'i mbyllim dhe t'ua pamundësojmë grupeve kriminale siç ka qenë kjo, që të fusin, qoftë njerëz, qoftë armatim dhe materiale të tjera brenda territorit të Kosovës. Të njëjtën gjë është duke e bërë edhe KFOR-i. Jemi në komunikim të ngushtë që të ndajmë disa përgjegjësi dhe zona atje në mënyrë që të krijojmë sa më shumë komunikim".

BQK-ja: Investimet direkte në Kosovë arrijnë mbi 440 milionë euro

PRISHTINË, 5 TETOR - Investimet direkte në Kosovë deri në fund të korrikut 2023 ishin për 20 milionë euro më të larta dhe shënuan vlerën prej 443.3 milionë eurove. Kështu thuhet në raportin e Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) mbi bilancin e pagesave për muajin korrik 2023, duke shtuar se investimet jashtë vendit shënuan vlerën e mbi 120 milionë eurove. "Investimet direkte në Kosovë deri në fund të korrikut 2023 ishin për 20 milionë euro më të larta dhe shënuan vlerën 443.3 milionë euro krahasuar me 423.2 milionë euro

që ishin deri në fund të korrikut 2022, përderisa investimet direkte jashtë Kosovës shënuan vlerën e 121 milionë eurove, ku një vit më parë ishin 89.3 milionë euro", thekson raporti.

BQK-ja shton se për tremujorin e dytë të 2023-s ka pasur rritje të aseteve të jashtme. "Asetet e jashtme në tremujorin e dytë 2023 janë rritur për 161.7 milionë euro nga tremujori paraprak, duke arritur vlerën 6.8 miliardë euro. Rritjes së aseteve gjatë kësaj periudhe i kanë kontribuar kategoria e investimeve direkte për

52.6 milionë euro, investimet në letra me vlerë janë rritur për 43.8 milionë euro, investimet e tjera janë rritur për 50.6 milionë euro dhe asetet rezervë janë rritur për 14.6 milionë euro", shton BQK-ja. Aty thuhet se ka pasur rritje të borxhit të jashtëm dhe se pjesëmarrja e tij në sektorin publik është 24 për qind. "Borxhi i jashtëm bruto, i cili përfshin borxhin publik dhe privat, në fund të tremujorit të dytë 2023, arriti vlerën 3.56 miliardë euro, i cili shënoi rritje për 112.9 milionë euro krahasuar me tremujorin e

parë të këtij viti", thuhet në këto të dhëna. "Borxhi i sektorit publik ka një pjesëmarrje rreth 24 për qind në gjithsej borxhin e jashtëm, vlera e të cilit në fund të qershorit 2023 ishte 841.8 milionë euro, ndërsa borxhi i sektorit privat shënoi vlerën 2.73 miliardë euro", vijon raporti.

Sa i përket tregtisë së mallrave, BQK-ja thotë se bilanci ka shënuar një deficit prej rreth 2.5 miliardë euro. "Bilanci tregtar në mallra deri në korrik 2023 kishte deficit në vlerë 2.47 miliardë euro, që është pothuajse në të njëjtin nivel

krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, por me një përkeqësim të lehtë, deficit më i lartë prej 3.8-përqindësh", thotë BQK-ja.

Më tutje theksohet se eksporti për këtë periudhë është zvogëluar për 6.2 për qind dhe shënoi vlerën e 498.3 milionë eurove, ku 531.2 milionë euro ishte deri në korrik 2022. "Ndërsa importi i mallrave shënoi rritje të lehtë prej 2-përqindësh duke arritur vlerën e 2.96 miliardë eurove, ku 2.91 miliardë euro ishte deri në korrik 2022", përfundon raportin i BQK-së.



"Pakoja e energjisë dhe projektet e tjera të financuara nga BE-ja po tregojnë rezultate pozitive"

PRISHTINË, 5 TETOR - Në fillim të vizitës zyrtare në Bruksel, zëvendëskryeministri i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog i Kosovës, Besnik Bislimi, është takuar me drejtorin e përgjithshëm për Fqinjësi dhe Negociatat e Zgjerimit të BE-së, Gert Jan Koopman.

Zëvendëskryeministri Bislimi u shoqërua në këtë takim nga ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli. Temë qendrore e diskutimit ishin projektet në bashkëpunim me Bashkimin Evropian si dhe perspektiva e zgjerimit të BE-së.

Zëvendëskryeministri Bislimi ka theksuar se Republika e Kosovës e vlerëson lart iniciativën e Komisionit të BE-së për planin e ri për zgjerim prezantuar nga presidentja e Komisionit, Von Der Leyen, si dhe pritshmëritë e Këshillit të BE-së, përfaqësuar nga presidenti i Këshillit, Michel, që zgjerimi të arrihet deri më 2030. Siç njofton zyra për informim e



qeverisë, Kosova e sheh veten pjesë të familjes evropiane. "Viti i kaluar ka qenë veçanërisht vit evropian për Kosovën. Vendi ynë ka aplikuar për anëtarësim në BE dhe Këshill të Evropës pas punës së përkushtuar të

institucioneve të Republikës për arritjen e liberalizimit të vizave. Përtej barrierave me të cilat jemi përballur, vendi ynë ka performuar më lart edhe se vendet e tjera të rajonit, veçanërisht në indikatorë



ekonomikë e të sundimit të ligjit. Kjo është dëshmi e potencialit tonë për rritje, zhvillim dhe gatishmëri për hapa të rëndësishëm në integrimin evropian, andaj është momenti që Kosovës t'i

hiqen pengesat në rrugëtimin drejt BE-së", është bërë me dije në njoftimin e Qeverisë së Kosovës.

Duke iu referuar këtij njoftimi, ministrja Rizvanolli foli mbi projektet në kuadër të Pakos për Energji financiar nga BE-ja, si dhe impaktin e shpejtë pozitiv që po e kanë këto projekte. "Sektori i energjisë është një nga sektorët ku qeveria është përqendruar në trajtimin e barrierave të të gjitha aspekteve, andaj pakoja e energjisë si dhe projektet e tjera të financuara nga BE-ja, Qeveria e Republikës, apo institucione të tjera ndërkombëtare, janë mirë të planifikuara dhe po tregojnë rezultate pozitive", u tha në njoftimin për medie.

Së fundmi, u theksua se procesi i integritimit evropian duhet të jetë i bazuar në meritokraci dhe t'i ofrojë instrumentet e barabarta për të gjitha shtetet, me qëllim të avancimit të agjendës evropiane dhe përbushjes së reformave.

Ka një "lidhje të errët", mes flijimit të lashtë njerëzor dhe botës tonë moderne



Nga Sarah KAPLAN

Në Japoni, thuhej se flijimi i një gruaje në një lumë të harbuar do të qetësonte shpirtin që jetonte aty, duke mundësuar ndërtimin e urave dhe kalimin e sigurtë të anijeve. Në mitin grek, mbreti luftëtar Agamemnon vendos të vrasë vajzën e tij, në këmbim të një ere të qetë në rrugën drejt Trojës. Ndërsa egjiptianët i varrosën disa nga faraonët e tyre bashkë me dhjetëra nëpunës kur këta të fundit vdisnin, për të siguruar që nevojat e tyre të përmbusheshin sërish edhe në jetën e përtejme.

Trupat e gjetur të varrosur në kënetat e ndryshme në Evropë, mund të jenë vrasjet si dhuratë për pushtetet e epërme. Qytetërimet e mëdha të Mesoamerikës vrisnin njerëz, hidhnin ushqimet dhe zhynin në ujëra thesare, për të paguar borxhet ndaj perëndive të tyre. Njerëzit e lashtë mund të vrisnin në një milionë mënyra të ndryshme, dhe mund t'iu jepnin një milionë arsye të ndryshme pse kjo është e nevojshme të bëhet.

Në shumë pjesë të botës para-moderne, rituali i flijimit konsiderohej si e nevojshme për të mirën e shoqërisë në përgjithësi – e vetmja mënyrë për të garantuar të korra të bollshme apo suksese në luftë. Por një studim i ri sugjeron se priftërinjtë dhe sundimtarët që vendosnin mbi vrasje të tilla, mund të kenë pasur një motiv. Nga një analizë e dhjetëra kulturave austroneziane, u zbulua se praktikën e sakrificës njerëzore qenë të prirur për ta kryer shoqëritë gjithnjë e më pak egalitare, çka përfundimisht garanton ritjen e pushtetit të trashëguar të një klase sunduese. Me fjalë të tjera, vrasjet rituale ndihmuan për të mbajtur pushtetin dhe të gjithë të tjerët në kontroll.

Kjo gjetje mund të duket intuitive – shoqëritë, në të cilat disa anëtarë vriten zakonisht ndoshta vlerësojnë disa jetë të caktuara mbi të tjerat – por ajo ka implikime më të gjera, u shprehën studiuesit në artikullin e

tyre për revistën 'Nature'. Ata sugjeron ekzistencën e një "lidhje të errët ndërmjet fesë dhe evolimit të shoqërive moderne hierarkike", shkruajnë ata, duke shtuar se "vrasjet rituale, ndihmuan kalimin e njerëzve nga grupe të vogla egalitare të etërve tanë në grupe më të mëdha, dhe shoqëri të shtresëzuara që ekzistojnë në ditët e sotme".

Shumë sociologë kanë teorizuar në lidhje me këtë çështje, thona studiuesit, por nuk ka pasur shumë studime rigorozë shkencore se si u arrit në një proces të tillë. Shkencëtarët përdorën analizën filogjenetike – një mjet që është përdorur fillimisht për ndërtuar pemën evolutive të familjes, por që mund të aplikohet edhe nga sociologët për të studiuar zhvillimin e gjuhëve – për të paraqitur marrëdhëniet midis 93 kulturave që u shqyrtuan.

Kjo i lejoi ata të shihnin nëse tiparet që po kërkonin qenë të trashëguara ose të adoptuara nga kultura të tjera, si dhe i ndihmoi të përcaktojnë marrëdhëniet shkakësore midis sakrificës njerëzore dhe shtresëzimit. (Të njëjtët shkencëtarë e përdorën këtë teknikë vitin e kaluar për një studim, që argumentoi se besimi tek ndëshkimi i mbinatyrshëm i dha hov kompleksitetit politik.)

Ata studiuuan prejardhjen nga një shoqëri udhëtarësh nëpër oqeanë që e kishte fillimin në Tajvan, por më pas kaluan nëpër Paqësor deri në jug në Zelandën e Re, dhe në lindje deri në ishullin e Pashkëve. Grupi ishte ndërkohë jashtëzakonisht i ndryshëm, duke përfshirë edhe dy komunitete të vogla egalitare me bazë familjare në Isneg të Filipineve, dhe shoqëritë e mëdha të Ishujve Havai, të cilat ishin shtëpia e shteteve komplekse me familje mbretërore, skllevër, dhe me një popullsi prej 100.000 banorësh që shpesh hynin në konflikt me njëri-tjetrin.

Duke u bazuar tek të dhënat historike dhe etnografike, hulumtuesit i vlerësuan kulturat në bazë të nivelit të tyre të shtresëzimit dhe identifikuan ato që praktikonin ritualin e flijimit të njerëzve. Motivët

dhe mënyrat e vrasjeve ndryshonin tek të gjithë kulturat. Sakrificat mund të kërkoheshin për vdekjen e një shefi, ndërtimin i një shtëpie, fillimin e një lufte, shpërthimin e ndonjë sëmundje apo shkeljen e një tabuje shoqërore.

Viktimat mund të mbyteshin në tokë, në ujë, digjeshin, varroseshin të gjallë, shtypeshin me një barkë të sapo-ndërtuar ose mbështilleshin me një rrogë dhe më pas u pritej koka. Por lidhja mes flijimeve dhe hierarkive sociale, duket se i kapërcen këto dallime. Viktimat qenë pothuajse gjithmonë të një statusi social të ulët, dhe sa më shumë e shtresëzuar të ishte kultura, aq më të përhapura kishin të ngjarë të ishin vrasjet rituale.

Nga 20 shoqëritë e "egalitare" që ata studiuuan – u quajtën kështu për shkak se nuk lejonin trashëgiminë e pasurisë dhe statusit mes brezave – vetëm 25 përqind e tyre e praktikonin sakrificën njerëzore. Në të kundërt, 37 përqind e 46 shoqërive të shtresëzuara në mënyrë të moderuar – ku pasuria dhe statusi mund të trashëgoheshin, por nuk ishte e lidhur domosdoshmërisht me standardet shumë të ndryshme të jetesës ose klasave të privileguara sociale – e përdornin atë praktikë.

Dhe në mesin e 27 kulturave shumë të shtresëzuara, ku dallimet e trashëguara mes klasave zbatoheshin në mënyrë rigorozë me pak mundësi për mobilitet social, një shumicë dërrmuese prej 65 përqind kryente vrasjet rituale. Pemët filogjenike ilustruan se vrasjet rituale prireshin për t'i paraprirë hierarkive shoqërore, dhe pasi ndodhi shtresëzimi, ato shërbyen për ta përforcuar këtë të fundit.

Ishte shumë e vështirë për një kulturë të kthehej tek barazia, pasi diferencat mes klasave qenë vendosur njëherë. Ky konstatim mbështet "hipotezën e kontrollit social" të sakrificës njerëzore, thanë studiuesit. Kjo ide sugjeron se vrasjet rituale janë një mënyrë për të terrorizuar njerëzit deri në nënshtrim, duke i lejuar udhëheqësit fetarë dhe politike (dhe

në shumë kultura, ata ishin një dhe të njëjtët), të urdhërojnë vrasjet për të konsoliduar pushtetin pa patur kundërshtarë.

Duke folur për 'Smithsonian Magazine', drejtuesi i ekipit kërkues Xhozef Uots, vuri në dukje se vrasjet rituale kanë ndodhur shpesh në ceremonitë e ndërlukuara që shfrytëzoheshin si si një shou televiziv sot. "Kjo nuk është vetëm një çështje e vrasjes në mënyrë efikase. Është më shumë se kaq. Terrori dhe spektakli i aktit maksimizohen në efektin e vet". Frika që frymëzonin flijimet njerëzore, shërbenin si një hap "për të ndihmuar në ndërtimin dhe ruajtjen e pushtetit në shoqëritë e hershme hierarkike" – shkruan Uots në faqen e tij në internet. Pasi autoriteti i tyre bëhej absolut, elitat mund të përdorin metoda më tradicionale – të policimit, taksimit, luftës – për të ruajtur sistemin e klasës në vend.

"Njerëzit shpesh thonë se feja mbështet moralin" – është shprehur Uots për revistën 'Science'. Por ai shton se studimi i tij ilustron se si ritualet fetare të sakrificës njerëzore janë të dizajnuara shpesh për t'i shërbyer dikujt tjetër, përveç perëndive. "Kjo dëshmon se si feja mund të shfrytëzohet nga elitat sociale për të mirën e tyre". Sigurisht kjo është një ide shumë e zymtë. Por mund të ketë qenë e nevojshme.

Ndarja e njerëzve në grupe me pasuri dhe status të pabarabartë, ishte jetike për zhvillimin e qytetërimit modern, shkruan Uots. Hierarkitë ndihmuan në ritjen e qyteteve dhe perandorive të mëdha, të afta për të ndërmarrë projekte masive të punëve publike dhe krijimin e veprave të paçmuara të artit. Sigurisht, njerëz të panumërt u shtypën (dhe, sipas këtij studimi vrasje) në këtë proces.

Por gjithësesi, klasa ishte jetike për të na sjellë këtu ku jemi sot. "Unë mendoj se është absolutisht një projekt i rëndësishëm" – tha psikologu Xhozef Hainrish nga Universiteti i British Columbia për 'Neë Scientist'. "Fljimi duket se është

kryer në shoqëritë e gjithë botës". Por ai shprehu dyshime rreth përfundimeve të studimit. Edhe pse sakrificat njerëzore mund të ketë qenë e lidhur me shtresëzimin në shoqëritë austroneziane, Hainrish u shpreh mosbesues për analizën filogjenetike të përdorur për të provuar se lidhja qe shkakësore.

Ky mjet supozon se shtresat sociale dhe ritualet fetare zhvillohen përmes brezave, në të njëjtën mënyrë si gjuha. Hainrish thotë se sakrificat njerëzore është zhdukur në një rajon prej disa qindra vjetësh, por gjuhë vazhdon të trashëgohet ende nga prindi tek fëmija – duke dëshmuar se këto dy aspekte të kulturës nuk janë të detyruara të zhvillohen në të njëjtën mënyrë. Ekziston ndërkohë rreziku i tepërimit me përgjithësimet e përfundimeve të studimit. Ajo që është e vërtetë për vrasjet rituale në kulturat austroneziane, mund të mos zbatohet për atzektë apo egjiptianët e lashtë. Dhe çfarëdo roli që mund të ketë luajtur sakrificat njerëzore në ato shoqëri, ajo mbetet ende vetëm një nga aspektet e kulturës – dhe s'mund të bëhet tërësisht përgjegjëse për hierarkitë komplekse dhe sistemeve e ngurta klasore, të cilat kanë dominuar prej kohësh pjesën më të madhe të botës moderne.

Megjithatë, studiuesit e fesë u shprehën se qenë të kënaqur të shihnin një analizë rigorozë të dhënave, si ai i përdorur në studimin e publikuar tek 'Nature'. "Studimi i fesë ka qenë i infektuar në shumë aspekte nga një bollëk idesh dhe mungesa e testeve të forta sasore të këtyre ideve" – shprehet Richard Sosis, një ekspert mbi sjelljen ekologjike të njeriut në Universitetin e Konektikut për 'Science'. "Këto metoda kanë fuqi, dhe me siguri përbëjnë një hap përpara mbi mënyrën se mund të vlerësojmë idetë. A janë ato pjesa e fundit e enigmës? Jo!" Por, shtoi ai, "të paktën diskutimi mund të fillojë këtu dhe në një mënyrë sistematike që nuk ka ndodhur më parë". / Quartz – Bota.al



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Muja pas golit në LK: Historia u shkrua

Antwerp, 5 tetor - Reprerentuesi i Kombëtares së Shqipërisë, Arbnor Muja, e ka shënuar golin e parë në Ligën e

Kampionëve. Ky gol është historik për skuadrën belge Royal Antwerp pasi ishte i pari në histori të fazës së grupeve

për Ligën e Kampionëve. Ndryshe Royal Antwerp F.C. pësoi humbje nga Shakhtar Donetsk me rezultat 3-2. "Goli i

parë ndonjëherë në Ligën e Kampionëve për Royal Antwerp F.C. Historia u shkrua", ka shkruar Muja në "Facebook".



Ballkani gjunjëzon Dinamo Zagrebin

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 5 TETOR - Skuadra e Ballkanit ka arritur edhe një sukses të madh në arenën ndërkombëtare, pasi të ënjtën mbrëma e mposhti kampionen e Kroacisë, Dinamo Zagreb, me rezultat 2-0. Ndeshja e zhvilluar në stadiumin "Fadil Vokrri" është në kuadër të fazës së grupeve në Ligën e Konferencës, teksa për portokallezënjtë e Suharekës kjo ishte fitorja e parë në fazën e grupeve në këtë edicion. "E kemi analizuar shumë mirë ndeshjen dhe të gjithë e kemi dhënë 100%. Besoj që e kemi merituar fitoren sonte. Ky ishte momenti më i rëndësishëm në karrierën time. Normalisht që rriten ambiciet tona për me kaluar grupin, edhe pse do të

jetë shumë vështirë", ka thënë pas ndeshjes, Almir Kryeziu. Kampionët kosovar të drejtuar nga strategu Ilir Daja kanë shfaqur lojë të mirë dhe arritën të korrin një fitore të madhe ndaj një klub mjaftë të fuqishëm evropian. Rezultatit e zhbllkoi Almir Kryeziu në fund të pjesës së parë dhe gëzimi tek tifozët në stadiumin "Fadil Vokrri" ishte i madh. Në pjesën e dytë, klubi kroat tentoi për të barazuar rezultatit, por ishte skuadra e Ballkanit që realizoi edhe një herë në minutën e 84-t, kur realizoi për 2-0 sulmuesi algerian, Walid Hamidi. Ndeshjen e radhës në Ligën e Konferencës, Ballkani e luan më 26 tetor, ku sërish do të luajë para tifozëve të vet kundër Astanas, skuadër e cila në dy ndeshjet e para ka pësuar dy humbje.



Muslija, lojtarëve të rinj: 'Dardan' me vepra, jo me fjalë

PRISHTINË, 5 TETOR - Mesfushori i Paderbrorit në Gjermani, Florent Muslija, në "Instagram", më saktësisht në Instastory, ka dhënë një mesazh për të gjithë lojtarët e grupmoshave, se Kosova duhet të jetë një zgjedhje zemre dhe jo ngritje në aspektin personal. Muslija ka rrëfyer për rrugëtimin e tij për te Kosova, duke zbuluar se ai e ka refuzuar Gjermaninë dhe kombëtare të tjera vetëm që të luajë për "dardanët". "Mbështetje dhe respekt për Kosovën. Në çdo kohë në mbështetje të Kosovës. Edhe kur isha keq, por edhe tani kur jam mirë, i thashë PO Kosovës edhe në momentin që isha pjesë e U20 dhe i ftuar tek U21 e Gjermanisë. Kishte tendenca



joshjeje edhe nga shumë kombëtare që unë të ndërroj mendje. Kosova është shteti ynë i cili u krijua me mund dhe sakrificë, e FFK-ja si pjesë e shtetit tonë po

ashtu kaloi në izolim për rreth tri dekada, ndërsa kishte sakrificë nga shumë gjenerata që na ta gëzojmë tani këtë periudhë, që ta përfaqësojmë shtetin tonë në të

gjithë globin", ka shkruar Muslija. "Edhe atëherë Kombëtares e Gjermanisë e as sot Kombëtares e Kosovës nuk e shoh si promovim personal, por e kam parë dhe e shoh si krenari të përfaqësimit të shtetit të Kosovës dhe për t'i bërë të lumtur të gjithë qytetarët e vendit tim. Dhe tani kam një mesazh për të gjithë ata bashkëlojtarë të të gjitha grupmoshave. Është e drejtë legjitime e secilit që të vendosë me zemër. Është, po ashtu, e drejtë legjitime të analizosh, të konsultohesh (se ku dëshiron të luash). Ama në momentin që vendos me i thanë PO 'Dardanëve' edhe shtetit tënd, nuk është as morale e as profesionale dhe nuk ka asnjë arsye të ndërrosh mendje

për joshje të tjera", ka deklaruar Muslija. "Kosova ka qëndruar afër meje përmes përfaqësuesit të saj në Gjermani që nga moshën 12-vjeçare. FFK-ja të njëjtën gjë është duke e bërë me të gjithë në Gjermani e Evropë, dhe kjo më detyroj të reagoj, pasi që gjithë ky mund e gjithë kjo përkujdesje me vite për t'iu qëndruar afër të gjithë talenteve, nuk ishte dashtë të ketë vend për dëshpërim. Ta duam Kosovën. Dardan me vepra!", ka përfunduar 25-vjeçari. Vlen të cekët se Kosova rikthehet në aksion në javën e ardhshme, atëherë kur përballet me Andorrën (12 tetor), ndërsa tri ditë më vonë me Izraelin në kuadër të kualifikimeve për "Euro 2024".

Paraqitet logoja zyrtare e Kampionatit Evropian të Xhudos

Prishtinë, 5 tetor - Kampionati Evropian i Xhudos do të mbahet për herë të parë në Kosovë më 16 dhjetor në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë. Kjo pritet të jetë ngjarja më e madhe sportive e organizuar në Kosovë. 50 shtete do të jenë pjesëmarrëse me mbi 100 xhudistë/e elitare dhe do të garojnë për çmimin e madh prej 300 000 eurosh

në total në të gjitha kategoritë. "Shumë të lumtur të ndajmë me ju identitetin zyrtar të kësaj ngjarje të rëndësishme si për vendin tonë ashtu edhe për sportin e xhudos në Evropë dhe botë. Logoja e Kampionatit Evropian është frymëzuar nga ngjyrat bardh dhe kaltër të Prishtinës, qytetit ku do të mbahet Kampionati; ilustrimit të

objektit të Pallatit të Rinisë dhe Sporteve ku do të mbahet Kampionati më 16 dhjetor 2023; dhe ilustrimin e përhëndetjes - 'Rei' - në xhudo si një ndër elementet kryesore të xhudos që simbolizon respektin dhe mirënjohjen, kështu për ta reflektuar edhe vlerën kryesore të vendit tonë, mikpritjen dhe për ta

dëshmuar traditën e xhudos në Kosovë, vendin e tri medaljeve të arta olimpikë", thuhet në njoftimin e Federatës së Xhudos të Kosovës. Kampionati i Hapur Evropian i Xhudos "European Championships Open" organizohet në kuadër të programit shtetëror "Kosova, shtet i xhudos" nga Federata e



Xhudos e Kosovës, dhe mbështetet nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Federata Evropiane e Xhudos.

Leao: Nuk jemi të kënaqur me rezultatin ndaj Dortmundit, vetëm për fitore kundër PSG-së

MILANO, 5 TETOR - AC Milani luajti sërish baras në Ligën e Kampionëve dhe ishte ndeshja e katërt pa shënuar gol. Rafael Leao ka thënë se kuqezinjtë luajtën mirë dhe se e kanë merituar të shënojnë fitore ndaj Borussia Dortmundit. "Nuk jemi aspak të kënaqur me këtë lloj rezultati. Edhe

kundër Newcastelit e patëm kontrolluar ndeshjen dhe krijuam shumë raste, por përsëri nuk arritëm të shënonim. Edhe me Dortmundin e njëjta gjë, pavarësisht se luajtëm mirë në një fushë ku shumë skuadra vuajnë. Për aq sa treguam në fushë mendoj se meritonim të

dilnim nga Dortmundi me tri pikë. Në Ligën e Kampionëve gjërat ndërlikohen shumë shpejt kur as shënon e as fiton. Mendoj se bëmë një ndeshje cilësore dhe jam i lumtur për paraqitjen e skuadrës. E vetmja gjë që më lë të zhgënjyer është rezultati", ka thënë Leao. "Ndaj PSG-së na duhet fitorja. E dimë

fort mirë se jemi në një grup të vështirë, por në Paris do të shkojmë vetëm për të fituar. I respektojmë rivalët tanë sigurisht, edhe sepse kanë lojtarë cilësorë, por ne kemi objektiv ta kalojmë grupin dhe duam të bëjmë gjithçka për t'ia dalë mbanë", ka deklaruar Leao.



Bushi: Synojmë Evropianin

TIRANË, 5 TETOR - Ekipi kombëtar U21 i Shqipërisë gjatë këtij muaji ka dy ndeshje të forta dhe shumë të rëndësishme në kualifikueset e Evropianit. Kuqezinjtë e rinj do të jenë të impenjuar në Finlandë dhe më pas presin Malin e Zi. Kombëtarja U21 ndodhet e para në grup pas dy ndeshjeve dhe si kurrë më parë është afër një kualifikimi historik. Pasi ka publikuar një ditë më parë listën e lojtarëve të grumbulluar, trajneri Alban Bushi shprehet se e di kualitetin që ka ekipi i tij ka dhe si objektiv për të shkuar në Evropian. "Ekipi kombëtar është një specifikë më vete, sepse ne marrim lojtarët që janë më në formë të momentit. Si Bibo dhe Selimaj kanë bërë paraqitje pozitive, por ne marrim ata që janë më të mirët. Këtë zgjedhje bëjmë ne. Unë jam i mendimit që si fitorja dhe humbja duhet ta ruash shumë shpejt. Me këtë strategji ecim dhe te dhomat e zhvishjes. Kur fitojmë dhe kur humbim duhet ta harrojmë dhe të shohim vendet e tjera. E dimë kush jemi dhe e dimë që skuadrat e tjera janë më lart se ne. Jemi një ekip i fortë kur bëhemi bashkë. Rumania shkonte 30 milionë euro dhe ne shkonim apo jo një milion. Po të shikosh dhe lojtarët që kemi, nuk është një grup që të gjithë kanë minuta në këmbë. Është e



kundërta me kundërshtarët. I qëndroj asaj që duhet të luftojmë 1 me 2. Duhet të falënderoj si Berishën si Shabanin. Do të na ndihmojnë në skuadrën tonë", ka thënë Bushi. "Ne kemi ecur, jemi përmirësuar. Bashkëpunimi me një grup sa më të gjerë na sjell edhe suksese. Kombëtarja A ka shumë futbollistë tani. Do të vijë një kohë që trajneri do ta ketë shumë të vështirë përzgjedhjen. Na kanë penalizuar gjithmonë këta lojtarë që na ka marrë ekipi A në të shkuarën. Mendoj se tani nuk na merr më sepse mendoj se nuk janë gati për Kombëtaren A. Kemi dhe dy alternativa kur ekipi A të jetë pushim si Asllani dhe Mitaj. Bashkëpunimin e kemi pasur gjithmonë me stafin e Kombëtares. Është bashkëpunim më i mirë kësaj radhe. Ka sjellë avantazhet e veta. Na pëlqen. Stafit është zgjeruar dhe

trajneri nuk bën dot pa staf. Ne jemi përmirësuar nga viti në vit sepse punojmë. Këtë radhë do të shkojmë në limite. Nuk do të shkojmë për t'u mbrojtur. Ose kualifikim ose asgjë", ka deklaruar Bushi. "Mali i Zi është shumë i fortë, aq i fortë sa Finlanda. Është ekip që mund t'i marrë pikë kujtdo. Ka treguar që mund t'i marrë pikë shumë skuadrave. Nuk e kam menduar fare Malin e Zi. Në momentin që do ta mbarojmë ndeshjen me Finlandën atëherë do ta shohim Malin e Zi. Grupi e di shumë mirë që ka një qëllim për të shkuar në Evropian. E dimë se sa të fortë jemi. Është projektuar te grupi që duam të shkojmë në Evropian. Kjo më gëzon. Nga udhëtimi në Armeni ishim shumë të lodhur, ndërsa Rumania ishte më e freskët. Ky është qëllimi që i kanë vendosur vetes", ka pohuar Bushi.

LeBroni: Nuk e di se a do të jetë ky sezoni i fundit

LOS ANXHELOS, 5 TETOR - Pas 133 ditësh në heshtje, LeBron Jamesi ka folur për mediet, ditën e rikthimit të tij në fushë, për fazën përgatitore me Lakersat. Ky do të jetë sezoni i 21-të në NBA për "King James". "Ndiej se kam ende për t'i dhënë këtij sporti", u shpreh LeBron, që do të mbushë 39 vjeç në dhjetor. Lojtari ishte në dilemë për të luajtur apo jo kur u mbyll sezoni i kaluar, por në fund vendosi ta vijojë karrierën. Jamesi pranoi se do t'ia dedikojë këtë sezon djalit të tij Bronny, që po rikuperon nga një arrest kardial dhe një ndërhyrje kirurgjikale disa muaj më parë. Pavarësisht se do të jetë në fushë këtë sezon, nuk dihet nëse LeBron Jamesi do të luajë ende pas një viti. "Nuk e



di nëse ky është sezoni im i fundit apo jo. Për momentin mendoj për këtë vit", ka shtuar Jamesi, që konfirmoi zërat se mund të luajë me kombëtaren në "Paris 2024". "Është një objektiv që më intereson. Ndihehem ndryshe

pavarësisht se po shkoj 39 vjeç. Sigurisht që nuk jam më një 20-vjeçar, por për sa i përket nivelit tim të energjisë ndihem mjaft mirë. Të shohim se çfarë do të ndodhë këtë sezon, por jam gati", u shpreh LeBron Jamesi.

SHKURT

Shaqiri i shënon dy gola ndaj Inter Miami

Xherdan Shaqiri ishte protagonist kryesor i fitores së Chicago Fire kundër Inter Miami me rezultat 4-1 në ligën amerikane të futbollit. Reprezentuesi zviceran realizoi dy gola të bukur ndaj skuadrës për të cilën luan edhe ylli argjentinas Lionel Messi, por që nuk ishte në fushë për shkak të lëndimit. Anësori nga Gjilani golin e parë e realizoi në minutën e 49, kurse të dytin në të 73-n. Dy golat e tjerë për vendasit erdhën nga Selessie, ndërsa golin e nderit për Inter Miami e realizoi Martinez. Chicago Fire renditet në vendin e tetë me 40 pikë, kurse Inter Miami është e para fundit me 33 pikë.

Ferrari synon pozitën e dytë

Me Red Bullin që fitoi titullin kampion për konstruktorë, vëmendja është përqendruar te gara për vendin e dytë. Fillimisht ishte Aston Martin që shkëlqente pas makinës kampionë, më pas doli në skenë Mercedesi e më pas Ferrari e McLaren. Një betejë e fortë për ndjekësin e Red Bullit, me makinën italiane që duket favorite për vendin e dytë. Frederic Vasseur, drejtori sportiv i Ferrarit, ka deklaruar: "Gara e radhës në Katar do të jetë ajo që do ta verifikojë përparimin tonë. Nga gara e Holandës e deri më tani kemi mësuar shumë gjëra të reja për mënyrën se si ta menaxhojmë makinën dhe gomat. Kjo na jep mundësi të duelojmë me skuadrat e tjera për vendin e dytë. Deri në fund do të jetë një betejë të mjtash me makinat e tjera. Shkojmë në Katar me shpresën që të jemi sërish pretendentë. Dy të zhvillohet edhe gara sprint, ndaj synojmë të grumbullojmë sa më shumë pikë për të dalë të dytët", ka shtuar Vasseur.

Enrique: Rezultati 4-1 është i padrejtë

PSG-ja ishte favorite në letër për ndeshjen ndaj Newcastle Unitedit, por në fund pësoi debakël me rezultat 4-1. Trajneri Luis Enrique nuk e fshehu zhgënjimin për këtë humbje: "Ndeshje si këto janë gjithë të vështira për ne trajnerët. Gjithsesi, mendoj se djemtë patën sjelljen e duhur, por për të qenë i sinqertë mendoj se rezultati është pak i padrejtë. I bëj komplimentet e mia Newcastle për ndeshjen e madhe që zhvilluan".

Howe pas fitores ndaj PSG-së: Jam i lumtur për klubin dhe për tifozët

Newcastle Unitedi arriti një fitore magjike në "St. James's Park" ndaj Paris Saint-Germainit (4-1), me sfidën e dytë në Grupin F të Ligës së Kampionëve. Trajneri Eddie Howe lavdëroi ekipin e tij, si dhe vuri në dukje pikat kyçe të skuadrës, në fitoren historike ndaj PSG-së. "Mbrëmje fantastike për ne, kaq shumë histori për të folur brenda ndeshjes. Jam i lumtur për klubin dhe për tifozët, ajo që na dhanë sonte ishte e pabesueshme PSG është një ekip shumë i fortë, ndaj të cilit duhej të ishim të mirë në mbrojtje dhe më pas të rifillonim. Qëndrimi ynë ishte i shkëlqyer. Ne krijuam gjëra pozitive në pjesën e parë, me presing agresiv që është gjithashtu shenja jonë dalluese", ka thënë Howe.

Neueri rikthehet në ndeshjen ndaj Galatasarayt

Portieri i Kombëtares së Gjermanisë dhe Bayern Munchenit, Manuel Neuer, prej muajit dhjetor të vitit të kaluar është jashtë fushave të blerta,

pasi theu këmbën, teksa ishte duke bërë ski gjatë pushimeve pas Kupës së Botës. Drejtori sportiv i Bayernit, Kristof Frojnd, ka ndarë me tifozët

lajmin e shumëpritur për rikthimin e kapitenit. "Do të presim edhe pak ditë për ta parë Neuerin në krye të detyrës. Me shumë gjasa sfida kundër

Galatasaray do të jetë e duhura që ai të jetë në pozitën e numrit 1. Manuel na ka munguar të gjithëve. Procesi i rikuperimit po ecën shkëlqyeshëm dhe ai

ka dhënë reagimin e duhur në të gjitha testet e kryera, sikurse me seancat stërvitore, tregues se është i gatshëm të japë më të mirën", u shpreh Frojnd.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Në bazë të vendimit të Komisionit të posaçëm për shqyrtimin e kandidatëve për emërim në Gjykatën Kushtetuese, datë 3 tetor 2023, publikohet:

FTESË / THIRRJE PUBLIKE

për

**PARAQITJEN E NOMINIMEVE PËR NJË (1) GJYQTAR NË
GJYKATËN KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

Komisioni i posaçëm për shqyrtimin e kandidatëve për emërim në Gjykatën Kushtetuese, në pajtim me nenin 114.1 të Kushtetutës dhe me nenet 4 dhe 6, të Ligjit Nr.03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, fton Kuvendin e Republikës së Kosovës, institucionet gjyqësore, fakultetet juridike, Odën e Avokatëve, Shoqatën e Gjyqtarëve dhe të Prokurorëve, partitë politike, personat e tjerë relevantë juridikë dhe individët, që të propozojnë kandidatë për zgjedhjen e një (1) gjyqtari të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Po ashtu, një person mund të propozojë veten për kandidat.

Komisioni në mënyrë të veçantë inkurajon gratë për të aplikuar.

Kualifikimet:

Kandidatët për pozitën e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës; juristë të shquar me reputacion të shkëlqyeshëm profesional, me jo më pak se 10 (dhjetë) vjet përvojë pune profesionale, veçanërisht në fushën e së drejtës publike dhe kushtetuese të dëshmuar, *mes tjerash*, përmes punës profesionale si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, shërbyes civilë ose mësimdhënës universitarë dhe punë të tjera të rëndësishme të natyrës juridike, individë me reputacion të shkëlqyeshëm moral, të cilët kanë aftësi të plotë veprimi dhe të cilët nuk janë dënuar për ndonjë vepër penale.

Të gjitha propozimeve dhe aplikacioneve për nominime, duhet t'u bashkëngjiten dokumentet si vijon:

- Formulari për nominimin e kandidatit;
- Formular të deklaramit të të nominuarit;
- Curriculum Vitae (C.V) (autobiografia);
- Letra e motivimit nga organizata ose institucioni propozues;
- Dëshmia se është shtetas i Republikës së Kosovës;
- Dëshmia për përgatitjen shkollore dhe profesionale;
- Dëshmia për përvojën e punës;
- Dëshmia se nuk janë të dënuar për ndonjë vepër penale.

Nominimet dhe aplikacionet duhet të dërgohen jo më vonë se deri më 25 tetor 2023, në orën 16:00.

Nominimet dhe aplikacionet dërgohen personalisht në adresën: Ndërtesa e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë - Rr. "Nëna Terezë" p.n. Drejtoria për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, Zyra N-217.

Aplikacionet mund të merren në këto vende:

Forma e shtypur: Në shërbimin përkatës të administratës të Kuvendit të Republikës së Kosovës, ose

Forma elektronike: në ueb- faqen e Kuvendit të Republikës së Kosovës – www.assembly-kosova.org

Informata të tjera plotësuese mund të merren, çdo ditë pune deri në orën 16:00, në numrat e telefonit: 038 200-10411, 038 200-10410 dhe 044 567-041.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Na osnovu odluke Posebne komisije za razmatranje kandidata za imenovanje sudija Ustavnog suda, od 3. oktobra 2023. godine raspisuje se sledeći:

POZIV / JAVNI POZIV

za

**PRIJAVLJIVANJE NOMINACIJA ZA JEDNOG (1) SUDIJU
USTAVNOG SUDA REPUBLIKE KOSOVO**

Posebna komisija za razmatranje kandidata za imenovanje u Ustavnom sudu, u skladu sa članom 114.1 Ustav Republike Kosovo i članovima 4 i 6 Zakona br. 03/L-121 o Ustavnom Sudu Republike Kosovo, poziva Skupštinu Republike Kosovo, pravosudne institucije, pravne fakultete, Advokatsku komoru, Udruženje sudija i tužilaca, političke partije, druga relevantna pravna lica i pojedince da predlože kandidate za izbor jednog (1) sudije Ustavnog Suda Republike Kosovo. Takođe, jedno lice može da predloži sebe za kandidata.

Komisija posebno podstiče žene da se prijave.

Kvalifikacije:

Kandidati za položaj sudije Ustavnog suda mora da budu državljani Republike Kosovo; istaknuti pravници sa odličnom profesionalnom reputacijom, ne kraćom od deset 10 (deset) godina stručnog rada, naročito u oblasti javnog i ustavnog prava, dokazanog, *između ostalog*, putem stručnog rada sudija, tužilaca, advokata, civilnih službenika ili univerzitetskog predavača i drugih značajnih poslova pravne prirode; lica sa odličnom moralnom reputacijom, radno sposobni, koji nisu kažnjavani za krivična dela.

Svim predlozima i aplikacijama za nominacije mora se priložiti sledeća dokumentacija:

- Formular nominacije kandidata
- Formular deklaracije nominiranog,
- Curriculum Vitae (C.V) ("autobiografija"),
- Preporuka organizacije ili institucije koja ga predlaže,
- Dokaz da je građanin Kosova,
- Dokaz o školskoj i stručnoj spremi.
- Dokaz o radnom iskustvu
- Dokaz da nisu kažnjeni za krivično delo.

Nominacije i aplikacije treba da se dostave najkasnije do 25. oktobra 2023. godine, u 16.00 časova.

Nominacije i aplikacije se lično dostavljaju na adresu: Zgrada Skupštine Republike Kosova, Priština – ul."Majke Tereze", bb. Direkcija za upravljanje ljudskim resursima, Kancelarija N-217.

Aplikacije se mogu uzeti na sledećim mestima:

Štampana forma: pri dotičnoj službi administracije Skupštine Republike Kosovo, ili *Elektronskom obliku:* internet–stranica Skupštine Republike Kosova - www.assembly-kosova.org

Ostale dopunske informacije mogu se dobiti svakog radnog dana do 16.00 časova na br. Telefona: 038 200-10411, 038 200-10410 dhe 044 567-041.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Na osnovu odluke Posebne komisije za razmatranje kandidata za imenovanje sudija Ustavnog suda, od 3. oktobra 2023. godine raspisuje se sledeći:

POZIV / JAVNI POZIV

za

**PRIJAVLJIVANJE NOMINACIJA ZA JEDNOG (1) SUDIJU
USTAVNOG SUDA REPUBLIKE KOSOVA**

Posebna komisija za razmatranje kandidata za imenovanje u Ustavnom sudu, u skladu članom 114.1 Ustav Republike Kosovo i članovima 4 i 6 Zakona br. 03/L-121 o Ustavnom Sudu Republike Kosovo, poziva Skupštinu Republike Kosovo, pravosudne institucije, pravne fakultete, Advokatsku komoru, Udruženje sudija i tužioca, političke partije, druga relevantna pravna lica i pojedince da predlože kandidate za izbor jednog (1) sudiju Ustavnog Suda Republike Kosovo. Takođe, jedno lice može da predloži sebe za kandidata.

Komisija posebno podstiče žene da se prijave.

Kvalifikacije:

Kandidati za položaj sudije Ustavnog suda moraju biti državljani Republike Kosovo; istaknuti pravnici odličnog profesionalnog ugleda, sa najmanje deset (10) godina radnog iskustva, posebno iz oblasti javnog i ustavnog prava, dokazanog, između ostalog, kroz profesionalni rad, kao: sudije, tužitelji, odvjetnici, civilni službenici ili sveučilišni predavači, te druge značajne poslova pravne prirode; osobe odličnog moralnog ugleda sa punom radnom sposobnošću, koji nisu bili kažnjavani za neko krivično djelo.

Svim predlozima i aplikacijama za nominacije moraju se priložiti dokumenta u nastavku, i to:

- Obrazac za nominiranje kandidata
- Obrazac deklaracije nominiranog
- Curriculum Vitae (C.V) ("autobiografija");
- Pismo motivacije / preporuka predlagača - organizacije / ustanove;
- Dokaz da je državljanin Republike Kosova;
- Dokaz o školskoj stručnoj spremi.
- Dokaz o radnom iskustvu.
- Dokaz da nisu kažnjeni za krivično delo.

Nominacije i aplikacije dostaviti najkasnije do 25. oktobra 2023. godine, u 16:00 sati.

Nominacije i aplikacije dostaviti osobno na adresi:
Zgrada Skupštine Republike Kosovo, Priština, ul. "Majke Tereze", bb.
Direkcija za upravljanje ljudskim resursima, Kancelarija N-217.

Aplikacije se mogu dobiti na sledećim mestima:

Štampani obrazac: u dotičnoj službi Administracije Skupštine Republike Kosovo, ili *Elektronskom obliku*: internet-stranica Skupštine Republike Kosovo - www.assembly-kosova.org

Ostale dodatne informacije mogu se dobiti svakog radnog dana, do 16:00 sati, na telefonima: 038 200-10411, 038 200-10410 dhe 044 567-041.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Anayasa Mahkemesi'ne hakimlerin atanması için adaylar listesinin görüşülmesinden sorumlu Özel Komisyon'un 3 ekim 2023 tarihli Kararı üzerine

**KOSOVA CUMHURİYETİ ANAYASA MAHKEMESİNE (1) BİR
HAKİM**

ATAMALARIYLA İLGİLİ

ALENİ ÇAĞRI/ DAVET

Anayasanın 114.1 Maddesi ve Kosova Cumhuriyeti Anayasa Mahkemesi hakkında 03/L-121 sayılı Kanunun 4 ve 6. Maddeleri uyarınca Anayasa Mahkemesine Atama Adaylarının Gözden Geçirilmesi Özel Komisyonu, Kosova Cumhuriyeti Meclisi, yargı kurumları, hukuk fakülteleri, Avukatlar Odası, Hakimler ve Savcılar Birliği, siyasi partiler, diğer ilgili tüzel kişiler ve bireyler, Anayasa Mahkemesinin seçimi bir (1) aday için, göstermek için Kosova Cumhuriyeti'nin. Ayrıca, bir kişi bir aday için kendini aday gösterebilir.

Komisyon özellikle kadınların başvuruda bulunmalarını teşvik etmektedir.

Kalifiyeler:

Anayasa Mahkemesi hakim görevine önerilen adaylar Kosova Cumhuriyeti vatandaşı olmalı; özellikle kamu ile anayasa hukuğu alanında ve diğerleri arasında hakim, yargıç, avukat, sivil memur ya da üniversite eğitmeni olarak çalışan ve diğer önemli hukuki işlerle uğraşan en azından on (10) yıllık çalışma görgüsüne ve bununla birlikte mükemmel uzmansal ünvanına sahip ünlü hukukçular olmalı; mükemmel ahlaki ünvanına sahip olmalı ve herhangi bir suç işi için cezalandırılmış olmamalı.

Atamalarla ilgili tüm önerilere ve tüm formlara aşağıda saymış olacağımız şu evraklar ilave edilmelidir:

- Adayın atanmasına ait form,
- Atanan kişinin demecinde bulunmasıyla ilgili form,
- Curriculum Vitae (C.V) (özgeçmiş),
- Adayın önerildiği örgüt ya da kurum tarafından motivasyon belgesi,
- Kosova vatandaşı olduğuna dair delil,
- Öğretim ile uzmansal hazırlığına ait delil,
- Çalışma görgüsüne ait delil.
- Herhangi bir suç işi için cezalandırılmış olmadığına dair delil.

Atamalar ile formlar en geç 25 Ekim 2023 tarihine ve saat 16:00'ya kadar gönderilmelidir.

Atamalar ile formlar şahsen şu adrese gönderilmelidir:
Kosova Cumhuriyeti Meclis Binası, Priştine, "Nëna Tereza" caddesi No'suz,
İnsan Kaynakları Yönetimi Direktörlüğü, Daire N-217.

Formlar şu yerlerden alınabilir:

§ Kosova Cumhuriyeti Meclisinin ilgili idari hizmetinde ya da
§ Kosova Cumhuriyeti Meclisinin www.assembly-kosova.org web sayfasında.

Konuyla ilgili diğer ek bilgiler her iş günü saat 16:00'ya kadar şu telefon numaralarından alınabilir: 038 200-10411, 038 200-10410 dhe 044 567-041.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Kuvendi i Republikës së Kosovës, shpall:

K O N K U R S
**Për zgjedhjen e 2 (dy) anëtarëve në Këshillin
Gjyqësor të Kosovës**

Në pajtim me nenin 10 të Ligjit nr. 06/L -055 për Këshillin Gjyqësor të Republikës Kosovës dhe me qëllim të përmbushjes së obligimit kushtetues dhe ligjor për zgjedhjen e anëtarëve në Këshillin Gjyqësor të Republikës së Kosovës,

Kuvendi shpall konkurs për plotësimin e pozitës:

- 1 (një) anëtar/e siç përcaktohet me nenin 108, paragrafi 6, nënparagrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (Amendamenti nr. 25 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës) nga radhët e gjyqtareve; dhe
- 1 (një) anëtar/e, siç përcaktohet me nenin 108, paragrafi 6, nënparagrafi 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nga radhët e gjyqtarëve.

Kandidati për anëtar në Këshillin Gjyqësor të Republikës së Kosovës, duhet t' i plotësojë kushtet e përcaktuara me Kushtetutë dhe me Ligjin për Këshillin Gjyqësor, dhe aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente përcjellëse:

- Autobiografia (Curriculum vitae);
- Dëshmia së është emëruar gjyqtar me mandat të përhershëm;
- Dëshmia se ndaj tij nuk është shqiptuar ndonjë masë disiplinore.

PROCEDURA E KONKURRIMIT

Aplikacionet duhet të dërgohen jo më vonë se deri më 25 tetor 2023, në orën 16:00.

Aplikacionet dërgohen personalisht ose me postë në adresën:

Ndërtesa e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë (Rr. "Nëna Terezë" pa nr., Drejtorja për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, Zyra N-217).

Aplikacionet mund të merren në këto vende:

Forma e shtypur: në recepcionin e ndërtesës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë, rr. "Nëna Terezë" pa nr. ose

Forma elektronike: faqja e internetit e Kuvendit të Republikës së Kosovës www.assembly-kosova.org
Informata të tjera plotësuese mund të merren, çdo ditë pune deri në orën 16:00, në numrat e telefonit: 038 200-10411, 038 200-10410 dhe 044 567-041.

Aplikacioni duhet të dorëzohet së bashku me dokumentet e kërkuara.

Përdorimi i aplikacionit të gabueshëm dhe të pakompletuar me të dhënat e kërkuara dhe me të dhëna të paraqitura me vonesë, konsiderohet i pavlefshëm.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Skupština Republike Kosovo raspisuje:

K O N K U R S
Za izbor 2 (dva) člana u Sudskom savetu Kosova

U skladu sa članom 10. Zakona br. 06/L-055 o Sudskom savetu Republike Kosovo iu cilju ispunjenja ustavne i zakonske obaveze izbora članova Sudskog saveta Republike Kosovo,

Skupština raspisuje konkurs za popunjavanje radnog mesta:

- 1 (jedan) član u skladu sa članom 108. stav 6. podstav 2. Ustava Republike Kosovo (Amandman br. 25. Ustava Republike Kosovo) iz reda sudija; i
- 1 (jedan) član, kako je definisano članom 108. stav 6. podstav 3. Ustava Republike Kosovo, iz reda sudija.

Kandidat za člana Sudskog saveta Republike Kosovo mora da ispunjava uslove utvrđene Ustavom i Zakonom o Sudskom savetu, a aplikaciji moraju biti priloženi sledeći propratni dokumenti:

- Autobiografija (Curriculum vitae);
- Dokaz o imenovanju za sudiju sa stalnim mandatom;
- Dokaz da vam nije izrečena disciplinska mera.

PROCEDURA KONKURISANJA

Aplikacije dostaviti najkasnije do 25. oktobra 2023. godine, u 16.00 časova.


Aplikacije se dostavljaju lično ili putem pošte, na adresu: Zgrada Skupštine Republike Kosovo, Priština (Ul. „Majka Tereza“ bb., Direkcija za upravljanje ljudskim resursima, N-217).

Aplikaciju možete uzeti u:

Štampanoj formi: na recepciji Zgrade Skupštine Republike Kosovo, Priština, ul. "Majka Tereza" bb. ili u *Elektronskoj formi:* internet-stranica Skupštine Republike Kosovo - www.assembly-kosova.org

Ostale dopunske informacije mogu se dobiti svakog radnog dana do 16.00 časova, na brojeve telefona: 038 200-10411, 038 200-10410 dhe 044 567-041.

Aplikaciju treba dostaviti uz zahtevana dokumenta. Korišćenje pogrešne, ili aplikacije koja nije kompletirana sa traženim podacima, kao i podaci dostavljeni sa zakašnjenjem, smatraju se nevažecim.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë




www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Ernis Rragomaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi".

- Arsim Jaha nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e Gjimnazit "Hajdar Dushi".

- Dr. Ukshin Ismaili, shpall të pavlefshme Licencën e Punës, të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë, Bordi Qendror për Regjistrim dhe Licencim me nr. KO-01754-01-01 datë: 29.09.1988.

- Armend Haxhikadrija nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e vitit të patë dytë dhe të katërt të shkollës së mesme ekonomike "Kadri Kusari".

- Luljeta Peci, shpall te pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "FAZLI GRAJQEVCI".

- Alij Misini, shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shkollës te mesme "ARKITEKT SINANI".

- Afrim Ferati, shpall te pavlefshme dëftesat e vitit te III,IV te shkollës se mesme te larte "Arkitekt Sinani", ish-shkolla Boris Kidriç.

- REGIONAL SH.P.K, shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb: 811999955.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

